



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

UDHËZIM

Nr 255, datë 03 . 11 .2015

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TARIFAVE PËR MARRËVESHJET E
KRIJIMIT TË SERVITUTIT NË PUNIMET MINERARE NËNTOKËSORE
HORIZONTALA

Në zbatim të nenit 102 , pika 4 , të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 pika 5 dhe 57 pika 4, të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 , “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Servituti në punimet minerare nëntokësore horizontale, që i përkasin një zone tjetër ekzistuese të lejuar minerare, krijohet vetëm me marrëveshje mes palëve ndërmjet zotëruesit të lejes minerare ekzistuese në të cilën gjenden punimet nëntokësore horizontale dhe zotëruesit të lejes minerare, i cili kërkon të përfitojë servitutin për bërë të mundur arritjen e trupit minerar.
2. Servituti në punimet minerare nëntokësore horizontale, krijon këto të drejta:
 - a) Të drejtën e kalimit në punimet nëntokësore horizontale që gjenden në zonën minerare që shfrytëzohet nga një subjekt i një leje tjetër minerare.
 - b) Të drejtën e kryerjes së punimeve nëntokësore në zona që përfshihen në zonën minerare që shfrytëzohet nga një subjekt i një leje tjetër minerare, me qëllim sigurimin e rrugëve të kalimit për të prekur trupin minerar, përfshirë edhe të drejtën e vendosjes së kablllove apo instalimeve të ndryshme.
 - c) Të drejta të tjera të parashikuara nga palët në marrëveshje.
3. Zotëruesi i lejes minerare mund të hyjë në një marrëveshje servituti me një subjekt tjetër minerar për punimet horizontale nëntokësore për lejet ekzistuese, në rastet kur:
 - a) Në projektin fillestar, të paraqitur nga zotëruesi i lejes, e të miratuar nga Struktura Përgjegjëse, është përcaktuar që punimet e hapura nëntokësore horizontale ekzistuese ose pjese të këtyre punimeve/punime ndihmese, të cilat ndodhen jashtë zonës së lejuar do të shërbejnë si punime hapje horizontale edhe për zonën e tyre.
 - b) Edhe pse nuk është parashikuar në projektin fillestar, gjatë shfrytëzimit konstatohet, se punimet e hapjes janë përfshirë brenda zonës së rrezikshme, të krijuara si rezultat i kryerjes së punimeve të shfrytëzimit para marrjes së lejes nga ish minierat shtetërore apo

nga shfrytëzimi i subjekteve fqinje dhe lind nevoja që të hapen punime të reja horizontale fushore për të shfrytëzuar rezervat e mineralit të cilat janë brenda zonës së subjektit.

II. Kushtet Kryesore

1. Zotëruesi i lejes minerare që përfiton të drejtën e servitutit sipas pikës 1:
 - a. Është i detyruar dhe ka përgjegjësi për mirëmbajtjen dhe kryerjen e riparimeve të nevojshme në punimet nëntokësore që shfrytëzohen për kalim nga ana e tij. Kushtet konkrete të mirëmbajtjes, përfshirë edhe vlerat përkatëse monetare që duhet të paguaj zotëruesi i lejes minerare në funksion të riparimeve dhe mirëmbajtjes së këtyre punimeve që përdoren për kalim, përcaktohen në marrëveshjen përkatëse të lidhur ndërmjet palëve.
 - b. Është i detyruar të respektojë të gjitha kushtet e përcaktuara në formatin e lejes minerare dhe në legjislacionin në fuqi për sektorin minerar.
 - c. Është i detyruar të respektojë rregullat e sigurimit teknik në punimet apo zonat nëntokësore që i përdor për kalim apo për kryerje të punimeve .
 - ç. Duhet ti shfrytëzojë këto punime vetëm në funksion të së drejtës së kalimit dhe nuk duhet të prekë apo të çënojë materialet minerare të zbuluara ose jo nga subjekti tjetër minerar, që gjenden në këto zona minerare që përdoren për kalim.
 - d. Nuk duhet të çënojë sigurinë në punë të subjektit tjetër minerar. Gjithashtu punimet nëntokësore që do të kryhen nga ana e zotëruesit të lejes minerare nuk duhet të pengojnë dhe të ndikojnë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë shfrytëzimin minerar të kësaj zone nga ana e subjektit tjetër minerar.
 - dh. Nuk duhet të shfrytëzojë mineraret që mund të zbulojë në zonën që i përket një leje tjetër minerare, zonë në të cilën kryen punime për të siguruar rrugë kalimi në mënyrë që të arrijë trupin minerar.
 - e. Në rast se nuk është parashikuar ndryshe në marrëveshje, subjekti tjetër minerar në zonën e lejes së të cilit do të kalohet apo do të kryhen punime nëntokësore të kalimit, ka detyrimin që të realizojë riparimet thelbësore që përfaqësojnë mirëmbajtje të rëndësishme të zonës përkatëse në të cilën do të kalohet apo do të kryhen punime nëntokësore të kalimit.
2. Zotëruesi i lejes minerare që përfiton të drejtën e servitutit dhe subjekti tjetër minerar në zonën e lejes së të cilit do të kalohet apo do të kryhen punime nëntokësore të kalimit, vendosjes së kabllave etj, janë të detyruar që përpara marrëveshjes, të verifikojnë gjendjen e zonave në të cilat kërkohet që të krijohet e drejta e servitutit. Kur zona nuk përmbush kushtet e funksionimit dhe sigurisë në punë, marrëveshja nuk mund të lidhet pa u normalizuar ato. Në çdo rast, strukturat përgjegjëse kanë të drejtë të kërkojnë ndërprerjen e marrëveshjeve të tilla që kanë të bëjnë me krijimin e të drejtës së servitutit në zona të rrezikshmëri. në zona, që i përkasin një leje tjetër minerare.
3. Kur nuk parashikohet ndryshe në marrëveshjen e lidhur ndërmjet palëve, servituti në punimet minerare nëntokësore që i përkasin një zone tjetër ekzistuese minerare, ka afat të njëjtë me afatin e vlefshmërisë lejes minerare përfituese dhe të lejes minerare ekzistuese.

4. Zotëruesi i lejes minerare që përfiton të drejtën e servitutit dhe subjekti tjetër mineral në zonën e lejes së të cilit do të kalohet apo do të kryhen punime nëntokësore të kalimit, kanë përgjegjësi solidare për respektimin e rregullave të sigurimit teknik në zonën ku do të kalohet apo do të kryhen punime nëntokësore të kalimit, përveç rasteve kur përgjegjësitë ndahen në marrëveshjen e servitutit të nënshkruar ndërmjet palëve.
5. Zotëruesi i lejes minerare që përfiton të drejtën e servitutit është i detyruar që gjatë dorëzimit të programit vjetor të veprimtarisë minerare të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse edhe marrëveshjen përkatëse të servitutit. Marrëveshja e servitutit, shqyrtohet nga struktura përgjegjëse në momentin e miratimit të programit vjetor, lidhur me çështjet e gjendjes tekniko minerare dhe ndikimin e zonave të rrezikshme.
6. Strukturat përgjegjëse kanë të drejtë që të kërkojnë anulimin e marrëveshjes së servitutit ose ndryshimin e kushteve të saj, në rast se parashikon realizimin e së drejtës së servitutit në zona të rrezikshme.

III. Tarifat

1. Në funksion të realizimit nga struktura përgjegjëse, të përgjegjësive të parashikuara në pikën 5 dhe 6 të kapitullit II, të këtij Urdhri, zotëruesi i lejes minerare, është i detyruar të paguajë vlerat përkatëse të shpenzimeve të nevojshme që i krijohen strukturës përgjegjëse. Shpenzimet që do të paguhën, për llogari të strukturës përgjegjëse, për kryerjen e procedurave të kontrollit të punimeve, që kërkohen të jenë objekt i një servituti, të cilat paguhën nga subjekti zotërues i lejes minerare përfitues i servitutit, janë të barabarta me shumën e përcaktuar në tarifat e miratuara të kryerjes së aktit të verifikimit gjatë procedurës së pajisjes me leje minerare shfrytëzimi.
2. Kur e drejta e servitutit nëntokësor është përcaktuar nga zotëruesi i lejes minerare dhe është miratuar nga struktura përgjegjëse në programin vjetor të veprimtarisë minerare, zotëruesi i lejes minerare që përfiton të drejtën e servitutit do t'i paguajë zotëruesit të lejes minerare për ushtrimin e të drejtës së servitutit, tarifa vjetore si më poshtë:

Nr	Për punim mineral horizontal	Vlera e plotë për një vit
1	Për gjatësinë nga 0 – 100 ml	L x 6000
2	Për gjatësinë nga 100 – 200 ml	(100 ml x 6000 lekë/ml) + (L-100) *5000
3	Per gjatësinë mbi 200 ml	(100 ml x 6000 lekë/ml) + (100 ml *5000 lekë/ml) + (L-200) ml * 4000 lekë/ml

	Shënim: L është gjatësia e punimit që i nënshtrohet servitutit	
--	---	--

3. Kur është e detyrueshme që për hapjen e një punimi të kalohet neper zonën e një subjekti tjetër që ka leje minerare, ky punim përshtatet që të plotësojë edhe kërkesat e subjektit që lejon hapjen e punimit në zonën e tij dhe ky i fundit e përdor këtë punim pa pagese.
4. Në tarifën e mesiperme përfshihet vetëm e drejta e kalimit në punimin nëntokesor horizontal dhe nuk përfshihen tarifën për përdorimin e infrastrukturës së prodhimit në sipërfaqe si sheshe depozitimi, rrugë tramozha, instalime mekanike etj të cilat përcaktohen në marrëveshje ndërmjet paleve.

IV. Zbatimi i Udhëzimit

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, gjatë shqyrtimit të programit vjetor për zhvillimin e veprimtarisë minerare verifikon zbatimin e projekteve të miratuara për zhvillimin e aktiviteteve minerare në drejtimin e servitutit për punimet që janë miratuar që në projektin fillestar apo punimet e hapura rishtas për shkak të zonave të rrezikshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

